



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 04 Prot.

Tiranë, më 04/01/2012

REKOMANDIM
Nr. 01, datë 04/01/2012

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, "Pro Credit Bank" sh.a.

KONSTATOVA

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, "Pro Credit Bank" sh.a. me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë, punonjës etj)
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara nga
- nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi Proces-Verbalin mbi shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit administrativ, pretendimet e kontrolluesit mbi këto shkelje si dhe provat e administruara, vëren se:

1. Kontrolluesi "Pro Credit Bank" sh.a, mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit me kamera CCTV, jashtë ambienteve të kontrolluesit, duke monitoruar dhe pjesën e trotuarit dhe rrugës ngjitur me godinën e tij, për kalimtarë të rastësishëm të cilët nuk janë subjekt i qëllimit të këtij përpunimi.

Komisioneri vlerëson shkelje të nenit 5 pika 1 germa "c" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, përmes përdorimit të sistemit me kamera CCTV në ambientet e jashtme, (trotuar, rrugë) ngjitur me godinën e tij.

Mbledhja e të dhënave personale (imazhet) të kalimtarëve të cilët nuk kanë lidhje me këtë kontrollues, është e tepërt lidhur me qëllimin për të cilin kontrolluesi mbledh dhe

përpunimi të dhënave personale (mbashkë) nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV, kështu që kështu në kundërshtim me:

- Nenin 5, pika 1, germa "c" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit "...të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim".
- Udhëzimin Nr. 3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme"
- Nenin 10, pika "a" të Rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare", miratuar me Vendimin Nr. 04, datë 19/01/2011 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Pa qenë subjekte të këtij përpunimi kalimtarët e rastësishëm automatikisht bëhet pjesë e këtij përpunimi i cili nuk ka për qëllim këtë kategori subjektësh. Ky lloj përpunimi cilësohet si ndërhyrje në jetën private të kalimtarëve, imazhet e të cilëve mund të përdoren në mënyrë abuzive për qëllime të tjera. Vëzhgimi i fasadës është mëse i mjaftueshëm nëse subjekti nga kalimtar i rastësishëm vendos të ndërmarrë sulme ndaj godinës, ambjentëve dhe territorit të kontrolluesit. Këto imazhe, sëbashku me imazhet e përpunuara nga CCTV në ambjentet e brendshme janë mëse të mjaftueshme për të zhvilluar hetime në lidhje me identifikimin dhe kapjen e autorëve të krimeve që dëmtojnë kontrolluesin.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative:

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 5, pika 1, germa "c" të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të Udhëzimit Nr. 3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme", të nenit 10, pika "a" të Rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare";
- Ndalimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditëve.
 - Shkatërrimin e të dhënave personale të mbledhura dhe përpunuara nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtroni veprimtarinë bankare dhe financiare brenda një afati prej 5 (pesë) ditëve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

